



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Nr. 6381 / Prot.

Tiranë, më 16.05.2024

**Lënda :** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Qendrës “FAKTOJE”

**TIRANË**

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 07.05.2024, dërguar me postë elektronike, nëpërmjet së cilës kërkohet informacion në lidhje me subjektet që përfitojnë nga ligji 33/2024 “Për dhënie amnistie”, ju informojmë si më poshtë:

1. Referuar pyetjes suaj, sa persona kanë përfituar deri më tani nga ligji Nr.33/2024 "Për dhënie amnistie", sqarojmë se, referuar veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme, të përcaktuara në nenin 75/a pika a të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se përjashtohen nga vuajtja e dënimit sipas nenit 3 të ligjit nr.33/2024 “Për Dhënie Amnistie” vetëm personat e dënuar për veprën penale të parashikuar në nenin 245/1 (*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publik*). Personat që kanë përfituar janë të ndarë në vite si më poshtë:
  - Për vitin 2023, janë 18 persona të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 të K. Penal, nga të cilët 3 prej tyre kanë qenë të dënuar me burgim dhe për shkak se janë subjekte përfituese të ligjit 33/2024 është bërë lirimi i tyre i menjëhershëm. Po kështu, edhe për 15 personat të tjerë, të cilët nuk janë të dënuar me burgim nga gjykata, për këtë vepër penale, por janë dënuar me kusht dhe me punë në interes publik është aplikuar përjashtimi nga ky dënim.
  - Për vitin 2024, janë 22 persona të dënuar për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të pa ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” të parashikuar nga neni 245/1 të K. Penal nga të cilët, 1 prej tyre ka qenë i dënuar me burgim dhe duke qenë subjekt përfitues i ligjit 33/2024 është bërë lirimi i tij i menjëhershëm. Për 21 persona të tjerë të cilët nuk janë të dënuar me burgim nga gjykata, për këtë vepër penale, por janë dënuar me kusht dhe me punë në interes publik aplikohet përjashtimi nga ky dënim.

2. Në lidhje me pyetjen tuaj sa persona janë dënuar nga GJKKO, vitin dhe uljen e dënimit të përfituar, informojmë se, në zbatim të nenit 5 të ligjit 33/2024 “Për Dhënie Amnistie”, nga regjistrat e ekzekutimit të vendimeve penale, rezulton se, për dënimet e dhëna nga GJKKO për vitin 2023 dhe 2024 përfitojnë ulje dënimi 44 persona të dënuar me kusht si më poshtë:
- 7 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 244 (*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*);
  - 11 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 319/ç (*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*);
  - 2 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 298 paragrafi 3 (*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*);
  - 9 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 259 (*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*);
  - 10 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 258 (*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*);
  - 1 person për veprën penale të parashikuar në nenin 248 (*Shpërdorimi i detyrës*);
  - 3 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 328 (*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*);
  - 1 person për veprën penale të parashikuar nga neni 197 (*Përcaktimi i rezultateve në garat Sportive*).

Personat e liruar nga burgju për efekt të uljes së dënimit për vitin 2023, sipas nenit 5 të këtij ligji ku përcaktohen kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit sipas neneve, rezulton si më poshtë :

- 2 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 248 (*Shpërdorimi i detyrës*);
- 2 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 259 (*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*);
- 3 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 284 paragrafi 2 (*kultivimi i bimëve narkotike kryer në bashkëpunim*);
- 1 person për veprën penale të parashikuar në nenin 298 paragrafi 3 (*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*);
- 1 person për veprën penale të parashikuar në nenin 190 paragrafi 2 (*falsifikimi i vulave , i stampave ose i formularëve*);
- 1 person për veprën penale të parashikuar në nenin 283 paragrafi 2 (*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve kryer në bashkëpunim*)

Personat e liruar nga burgju për efekt të uljes së dënimit për vitin 2024, sipas nenit 5 të këtij ligji ku përcaktohen kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit sipas akuzave përkatëse, rezulton si më poshtë:

- 2 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 259 (*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*);
- 3 persona për veprën penale të parashikuar në nenin 232/a (*Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste*).
- 1 person për veprën penale të parashikuar në nenin 298 paragrafi 3 (*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*);


- 3. Në lidhje me pyetjen tuaj sa persona janë të dënuar si funksionarë publikë, masën e dënimit dhe vitin, lutemi gjeni bashkëlidhur informacionin në formë tabelare.

Informacioni që po ju dërgojmë mund të jetë subjekt përditësimi, pasi të dhënat që përpunojmë janë në koordinim me institucione të tjera, si Drejtoria e Burgjeve, Shërbimi i Provës apo GJKKO, për vendimet që marrin të prerë para datë 31.03.2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ALTIN DUMANI**



**Tabela 2023- 2024 që përfitojnë përjashtim nga dënimi nga ligji për amnistinë**

|              |              |         |                       |        |   |
|--------------|--------------|---------|-----------------------|--------|---|
|              | viti<br>2023 |         |                       |        |   |
|              | 245/1        |         |                       |        |   |
| Nr           | Emer         | Mbiemer | Masa e denimit        | Neni   | <b>Funksioni</b>  |
| 1            |              |         | kusht 1 vit e 6 muaj  | 245/1  | Zyrtarë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës  |
| 2            |              |         | kusht per 2 vjet      | 245/1  | Pedagog i Akademisë së Sigurisë në Policinë e Shtetit                               |
| 3            |              |         | kusht 2 vjet e 8 muaj | 245/1  | Ish punonjës pranë AMA-s  |
| 4            |              |         | kusht 2 vjet e 8 muaj | 245/1  | Anëtar kompanie kabllori  |
| 5            |              |         | kusht 20 muaj         | 245/1  | Pa përcaktuar / Qytetar   |
| 6            |              |         | kusht 2 vite          | 245/1  | Avokat  |
| 7            |              |         | kusht 12 muaj         | 245    | Pa përcaktuar   |
| 8            |              |         | me kusht 3 vjet       | 245/1  | Shef finance në Këshillin e Qarkut Dibër  |
| 9            |              |         | kusht 2 vjet e 4 muaj | 245/1  | Specialist pyjesh,Diber   |
| 10           |              |         | kusht 4 vite          | 245 /1 | punonjëse në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor |
| 11           |              |         | kusht 12 muaj         | 245 /1 | Pa përcaktuar / Qytetar   |
| 12           |              |         | kusht 120 ore         | 245 /1 | Polic burgjesh  |
| 13           |              |         | kusht 60 ore pune     | 245 /1 | Anëtare pranë AMA-s   |
| 14           |              |         | kusht 2 vjet          | 245 /1 | Pa përcaktuar / Qytetar   |
| 15           |              |         | kusht 2 vjet          | 245 /1 | Pa përcaktuar / Qytetar   |
| 16           |              |         | burg                  | 245/1  | Punonjes Hipoteke   |
| 17           |              |         | burg                  | 245/1  | Pa përcaktuar /Qytetar  |
| 18           |              |         | burg                  | 245/1  | Pa përcaktuar /Qytetar  |
|              |              |         |                       |        |   |
| viti<br>2024 |              |         |                       |        |   |
|              | 245/1        |         |                       |        |   |
| Nr           |              |         | Masa e denimit        | Neni   | <b>Funksioni</b>  |
| 1            |              |         | kusht 2 vite 8 muaj   | 245/1  | Pa përcaktuar / Qytetar   |
| 2            |              |         | kusht 2 vite e 8 muaj | 245/1  | Polic   |
| 3            |              |         | kusht 80 ore pune     | 245/1  | Pa përcaktuar / Qytetar   |

|    |  |  |                       |       |                         |
|----|--|--|-----------------------|-------|-------------------------|
| 4  |  |  | kusht 2 vite          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 5  |  |  | kusht 16 muaj         | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 6  |  |  | kusht 8 muaj          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 7  |  |  | kusht 8 muaj          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 8  |  |  | kusht 16 muaj         | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 9  |  |  | kusht 8 muaj          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 10 |  |  | kusht 8 muaj          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 11 |  |  | kusht 120 ore pune    | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 12 |  |  | kusht 60 ore pune     | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 13 |  |  | kusht 60 ore pune     | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 14 |  |  | kusht 60 ore pune     | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 15 |  |  | kusht 120 ore pune    | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 16 |  |  | kusht 60 ore pune     | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 17 |  |  | kusht 8 muaj          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 18 |  |  | kusht 2 vite e 8 muaj | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 19 |  |  | kusht 1 vit e 4 muaj  | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 20 |  |  | kusht 1 vit e 4 muaj  | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 21 |  |  | kusht 2 vite          | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |
| 22 |  |  | burg                  | 245/1 | Pa përcaktuar / Qytetar |

Tabela e uljes se denimit sipas funksioneve

| Nr | Emer | Mbiemer | Masa e denimit          | Neni    | Funksioni                                |
|----|------|---------|-------------------------|---------|--|
| 1  |      |         | 4 vite kusht            | 259     | Ish drejtor i tatimeve,Korce             |
| 2  |      |         | 4 vite kusht            | 259     | Specialist Regjistri                     |
| 3  |      |         | 4 vite kusht            | 319 ç   | Prokuror                                 |
| 4  |      |         | 4 vite kusht            | 244     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 5  |      |         | 4 vite kusht            | 259/1   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 6  |      |         | 5 vite kusht            | 319 ç   | Oficer Policise Gjyqesore                |
| 7  |      |         | 4 vite kusht            | 298/1   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 8  |      |         | 4 vite kusht            | 298/1   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 9  |      |         | 3 vite kusht            | 197/a/2 | Zyrtar i klubit sportiv SHS<br>"Përmeti" |
| 10 |      |         | 8 muaj kusht            | 244     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 11 |      |         | 2 vite e 4 muaj kusht   | 319     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 12 |      |         | 3 vite kusht            | 319     | Avokat                                   |
| 13 |      |         | 2 vite kusht            | 319 ç   | Ish gjyqtare , Elbasani                  |
| 14 |      |         | 1 vit e 8 muaj kusht    | 244/2   | Zyrtar Kadastre                          |
| 15 |      |         | 4 vite kusht            | 319 ç   | ish inspektorin e SHKB                   |
| 16 |      |         | 20 muaj kusht           | 258     | Zyrtar Policie                           |
| 17 |      |         | 20 muaj kusht           | 258     | Zyrtare te MB                            |
| 18 |      |         | 20 muaj kusht           | 258     | Zyrtare te MB                            |
| 19 |      |         | 4 vite kusht            | 259     | Inspektor i AZHBR-së në<br>Korçë         |
| 20 |      |         | 16 muaj kusht           | 244     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 21 |      |         | 16 muaj e 24 dite kusht | 248     | Juriste B.Lushnje                        |
| 22 |      |         | 3 vite kusht            | 258     | Zyrtare B.Lushnje                        |
| 23 |      |         | 2 vite kusht            | 258     | Zyrtare B.Lushnje                        |
| 24 |      |         | 1 vit e 4 muaj kusht    | 328     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 25 |      |         | 16 muaj kusht           | 244/2   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 26 |      |         | 3 vite kusht            | 259     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 27 |      |         | 3 vite kusht            | 259     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 28 |      |         | 1 vit e 6 muaj kusht    | 244/1   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 29 |      |         | 2 vite e 8 muaj kusht   | 259/1   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 30 |      |         | 2 vite kusht            | 244     | Ish punonjes i Kadastres                 |
| 31 |      |         | 4 vite kusht            | 319 ç   | Oficere e policisë në Tiranë             |
| 32 |      |         | 16 muaj kusht           | 319 ç   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 33 |      |         | 16 muaj kusht           | 319 ç   | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 34 |      |         | 4 vite kusht            | 258     | Zyrtarë administrativë                   |
| 35 |      |         | 4 vite kusht            | 258     | Zyrtarë të Bashkisë së<br>Gramshit       |
| 36 |      |         | 8 muaj kusht            | 258     | Zyrtarë të Bashkisë së<br>Gramshit       |
| 37 |      |         | 8 muaj kusht            | 258     | Zyrtarë të Bashkisë së<br>Gramshit       |
| 38 |      |         | 8 muaj kusht            | 258     | Zyrtarë të Bashkisë së<br>Gramshit       |
| 39 |      |         | 2 vite e 8 muaj kusht   | 259     | Zyrtarët i AMA                           |
| 40 |      |         | 1 vit e 4 muaj kusht    | 319     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 41 |      |         | 1 vit e 4 muaj kusht    | 319     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |
| 42 |      |         | 16 muaj kusht           | 328     | Pa përcaktuar /Qytetar                   |

|    |  |              |       |                            |
|----|--|--------------|-------|----------------------------|
| 43 |  | 2 vite kusht | 328   | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 44 |  | 4 vite kusht | 259/2 | Punonjës i OSHEE-së        |
|    |  |              |       |                            |
| 45 |  | burg         | 248   | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 46 |  | burg         | 259   | Punonjës të IEVP Lushnje   |
| 47 |  | burg         | 259   | Mjeku i burgut             |
| 48 |  | burg         | 283/2 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 49 |  | burg         | 298/3 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 50 |  | burg         | 284/2 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 51 |  | burg         | 284/2 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 52 |  | burg         | 284/2 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 53 |  | burg         | 248   | Drejtor i Burgut Lushnje   |
| 54 |  | burg         | 190/2 | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 55 |  | burg         | 259/2 | Ish Inspektor Shendetsor   |
| 56 |  | burg         | 232/a | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 57 |  | burg         | 232/a | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 58 |  | burg         | 259/2 | Drejtor në Bashkinë Tiranë |
| 59 |  | burg         | 232/a | Pa përcaktuar /Qytetar     |
| 60 |  | burg         | 298/a | Pa përcaktuar /Qytetar     |